



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 673/1 prot

Tiranë me 22/04/2014

REKOMANDIM

Nr. 32, datë 22/04/2014

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, bazuar në nenin 29 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, ka kryer mbikëqyrjen dhe monitorimin e faqes të subjektit tuaj në internet www.panorama.com.al.

Subjekti juaj në cilësinë e kontrolluesit nëpërmjet faqes në internet www.panorama.com.al, gjatë aktivitetit që ushtron dhe shërbimeve që ofron, mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale të subjekteve të të dhënave.

Përdorimi i teknologjive të reja përmes përdorimit të internetit lejon mbledhjen e lehtë, të shpejtë dhe përpunimin e një numri të madh të të dhënave personale. Përdorimi i këtyre sistemeve apo teknologjive sjell përfitime për kontrolluesit dhe për subjektet e të dhënave personale, ato gjithashtu paraqesin një sfidë për mbrojtjen e vazhdueshme të të drejtave themelore të njeriut. Këto të drejta, në veçanti të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk duhet të minohen ose dobësohen thjesht sepse këto sisteme e kanë bërë më të lehtë ose më fitimprurës përpunimin e të dhënave.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private. Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore dhe është e sanksionuar edhe në Traktatin e Lisbonës. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon se: "*Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me veten e tij apo të saj. Të dhëna të tilla duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuara dhe në bazë të pëlqimit të personit të interesuar, ose në bazë legjitime të përcaktuara me ligj. Gjithkush ka të drejtën e aksesit ndaj të dhënave të cilat janë mbledhur në lidhje me të dhe të drejtën për të korigjuar të dhënat*".

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstaton se kontrolluesi "*Gazeta Panorama*" në faqen e tij në internet www.panorama.com.al nuk ka të publikuar rubrikën "*politikat e privatësisë*" me qëllim informimin e personave që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, si dhe masat e marra për sigurinë e të dhënave personale. Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. "*Politikat e privatësisë*" synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Mungesa e rubrikës "*politikat e privatësisë*" në faqen tuaj në internet www.panorama.com.al përbën shkelje të neneve 18 dhe 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Autoriteti i Komisionerit vlerëson parimin e transparencës së çështjeve të ndryshme sidomos edhe në faqen tuaj të internetit si kontrollues, por thekson edhe rëndësinë e transparencës në përpunimin e informacionit të subjekteve të të dhënave në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t'i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë etj. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 18, 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në faqen tuaj në internet të publikohen në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "*Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat*" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.
2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
3. Me plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2, të ligjit "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

